

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-22-0627*****Në ankesën e******Paditësi/Ankuesi*****B S**, nga Vitia , të cilin e përfaqëson avokati L E, Viti.***Kundër******E paditura*****N.SH. OP“ Agromorava” (në likuidim)**, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përberë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-II-13-0052-C0001 të datës 26 tetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 prill 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-II-13-0052-C0001 i datës 26 tetor 2022.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Në vitin 2007, paditësi e ka dorëzuar padinë, kundër të paditurës NSH“ Agromorava”, për anulimin e vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës- vendimit 369, të datës 26 qershor 1991 dhe kompensimin e të ardhurave personale, në Gjykatën Komunale në Viti, me shenjen C.nr.5/2007, por që kjo Gjykate me aktvendimin e saj

C.nr.7/2007 të datës 26 tetor 2011, ishte shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, dhe paditësi është udhëzuar ti drejtohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Paditësi me padi ju ka drejtuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, që ka shenjën C-III-12-0774, ashtu që Kolegji i shkallës së I-rë për padi pronësore dhe kreditore ka pranuar kompetencën dhe me aktvendimin e datës 26 shkurt 2013, ku pastaj kjo lëndë ka marre shenjën, C-II.-13-0052-C0001.

Më 12 shkurt 2014, AKP-ja ka dorëzuar mbrojtje me të cilën ka kërkuar që Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, ta hedhë padinë e paditësit si të pa pranueshme.

Më 17 mars 2014, paditësi përmes të autorizuarit të tij e ka dorëzuar parashtresën e përgjigjes në mbrojtje. Në parashtresë paditësi është deklaruar se është larguar nga puna duke u bazuar në ligje diskriminuese Serbe dhe jo vetëm ai, po edhe punëtorët e tjerë shqiptar. Paditësit me vendimin nr.345 të datës 19 qershor 1991 i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga Organi i Përkohshëm Punë drejtues i Ndërmarrjes, ndërsa me Vendimin nr.369 të datës 25 qershor 1991, është refuzuar kundërshtimi nda vendimeve të Organit të Përkohshëm Punë drejtues. Paditësi pas përfundimit të luftës në Kosovë, ai ishte lajmëruar në punë, po vendi i tij i punës ishte mbyllur, kështu që ka vendosur të punoi si arsimtar.

Më 04 dhjetor 2014, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së kishte marrë Aktvendim C-II-13-0052-C0001, me të cilin e ka pezulluar procedurën sipas padisë së paditësit për shkak se ndaj të paditurit ka filluar procedura e likuidimit.

Më 01 qershor 2021, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka lëshuar urdhër për paditësin dhe të njëjtit ju është kërkuar që ta plotëson padinë dhe ta dorëzoi një kopje të padisë bazë, C.nr.05/2007, për tu informuar se rasti a ka përfunduar apo në cilën fazë të procedurës gjendet, dhe se a ju keni drejtuar gjykatës për vazhdimin e procedurës meqë sqarimi ishte i nevojshëm për tu shmangur pengesa procedurale e gjyqëvarsisë të kësaj padie.

Me 09 qershor 2021, paditësi e ka dorëzuar parashtresën me të cilën ka bashkangjitur: Aktvendimin për themelimin e marrëdhënies së punës me kohë të paktuar 16 shtator 1987, Aktvendimin e datës 17 qershor 1991 me të cilin paditësit ju është caktuar vendi i punës si punëtor fizik në kopsht të njësisë punuese nga data 10 qershor 1991, Aktvendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës 19 qershor 1991, si dhe Kundërshtimin ndaj aktvendimit të datës 10 qershor 1991 dhe kundërshtimin ndaj Aktvendimit të datës 19 qershor 1991. Vendimin e datës 25 qershor 1991, me të cilat janë refuzuar kundërshtimet ndaj Aktvendimit nr.361 dhe 362, Propozimin për anulimin e vendimeve të paditurit, të datës 25 qershor 1991, fletë rekomnadi i lëshuar nga posta për dorëzimin drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, aktvendimin e gjykatës komunale në Viti C.nr.5/2007, të datës 26 tetor 2011, kopjen e padisë së paditësit drejtuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Me këtë parashtresë nuk e ka dorëzuar kopjen e padisë, C.nr.5/2007.

Më 08 korrik 2021, i autorizuari i paditësit ka dorëzuar parashtresën me të cilën është deklaruar në lidhje me çështjet faktike të rastit që ka të bëjë me ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe inicimit të kontestit para Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar, ka pohuar se procedura asnjëherë nuk kishte përfunduar.

Më 08 tetor 2021, Shkala e i-rë e DHPGJS-së përsëri kishte lëshuar urdhër C-II.-0052-C0001, për paditësin/ të autorizuarin e tij.

Më 18 tetor 2021, i autorizuari i paditësit e ka dorëzuar parashtresën, por edhe me këtë parashtresë, paditësi përsëri ka përsëritur pretendimet se procedura asnjëherë nuk kishte përfunduar para Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar. Ka shtuar se meqë nuk kishte përfunduar procedura, atëherë ai në vitin 2007 kishte paraqitur padi dhe se kjo gjykatë ishte shpallur jo kompetente dhe lënda është dërguar në DHPGJS. Paditësi sikurse edhe në shkresat tjera cek vlerën e kontestit në shume prej 30,100.00 euro.

Më 03 nëntor 2021, AKP-ja përmes përfaqësuesit e ka dorëzuar parashtresën në lidhje me kërkesën e paditësit për vazhdimin e procedurës së pezulluar. Me këtë parashtresë e ka kundërshtuar kërkesën e paditësit për vazhdimin e procedurës së

pezulluare me arsyetimi se paditësit i mbetet që të drejtën e vetë ta realizoi në procedurë të likuidimit.

Më 20 dhjetor 2021, i autorizuari i paditësit e ka dorëzuar parashtresën me të cilën e ka kundërshtuar e AKP-së dhe me të njëjtën është deklaruar se kërkesën e ka ushtruar në bazë të Udhëzimit të Gjykatës sipas aktvendimit për pezullimin e procedurës.

Më 16 maj 2022, Shkalla e I-re e DHPGJS-së ka caktuar seancë dëgjimore për të vepruar në lidhje me kërkesën për vazhdimin e procedurës se pezulluar, në të cilën kanë prezantuar për paditësin i autorizuari i tij L E dhe për të paditurin N Xh, në të cilën janë deklaruar palët ndërgjegjese.

Më 16 maj 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ka marr aktvendim C-II.-13-0052-C0001, me të cilin është pranuar kërkesa e paditësit për vazhdimin e procedurës sipas aktvendimit të datës 04 dhjetor 2014. Kundër këtij aktvendimi për vazhdim të procedurës nuk kishte pasur ankesë nga asnjëra palë ndërgjygjëse.

Më 14 tetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së kishte mbajtur seancë tjetër dëgjimore publike, në të cilën kanë prezantuar të autorizuarit e palëve ndërgjegjeje. I autorizuari i paditësit në lidhje me çështjet procedurale të ngritura nga gjyqtari i çështjes është deklaruar se nuk ka dëshmi që pas luftës është kërkuar vazhdimi i procedurës sipas propozimit të ushtruar pran Gjykatës së Punës së Bashkuar në Prishtinë, por kemi ushtruar padi në vitin 2007. Për një rast tjetër të ngjashëm Kolegji i Dhomës nuk e ka hedhur padinë e dytë. Më tej ka theksuar se nuk ka bërë përsëritjen e shkresave të lëndës të cilat janë zhdukur para luftës.

Për të paditurën përfaqësuesi i saj është deklaruar se sipas provave propozimi është ushtruar brenda aftit ligjor, po nuk e dimë çfarë ka ndodhur me procedurën a është regjistruar propozimi në gjykatë.

Me 26 tetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-II-13-0052-C0001 padinë e paditësit B S kundër të paditurës, në lidhje me anulimin e vendimeve të paditurës për ndërprerje të marrëdhënies së punës, gjegjësisht Vendimit nr.369, datë

25 qershor 1991, dhe kompensim të ardhurave, hedhet poshtë si e pa pranueshme. Shkalla e I-rë ka konstatuar se nuk është kontestuese fakti se paditësi ishte i punësuar në NSH,, Agromorava”, sipas aktvendimit të paditurës mbi formimin e marrëdhënies së punës, me kohë të pa caktuar, nr.364 më datës 16 shtator 1987, në vendin e punës, arakatar në një njësinë e punës në Gj. Në bazë të provës së aktvendimit nr.345, datë 19 qershor 1991 e paditura- Organi i Përkohshëm i punës Drejtuese nr.321, data 17 qershor 1991, paditësi ishte caktuar në vendin e punës, punëtor fizik nga data 10 qershor 1991. Me vendimin nr.369 të datës 25 qershor 1991 janë refuzuar kundërshtimet ndaj aktvendimeve nr.361 dhe 362, të datës 21 qershor 1991 dhe 321, dhe 345, te datës 17 qershor 1991 dhe 19 qershor 1991. Me provën për propozim për anulimin e vendimit dhe kthimit në vendin e punës kundër aktvendimeve 321 dhe 369 dhe 361 dhe 362, vërtetohet se paditësi ju ka drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, të cilin propozim e ka dorëzuar përmes dorëzimit postar, por që nuk e ka provë se propozimi a është regjistruar në regjistër të lëndëve.

Shkalla e I-rë e DHPGJS –së konstatuar se paditësi sipas parimit të barrës së provës, në kuptim të nenit 31.5, të Ligjit nr.06/L086, nuk e ka vërtetuar faktin se propozimi kundër të paditurës a është regjistruar në regjistrin e lëndëve në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, pastaj kjo lëndë është marrë në punë dhe nëse për këtë rast është vendosur, me ndonjë vendim procedural meritor. Në rastin konkret pra propozimi në fjalë është ushtruar brenda afatit të parapare me ligjin në fuqi të kohës, Ligjin Themelorë për marrëdhëniet e Punës i RSFJ-së nr.60/89 dhe 42/90, kapitulli 5, Mbrojtja e të drejtave të punëtorëve, neni 83, paragrafi 1 , që ka paraparë ,, Punëtori i cili nuk është i kënaqur me vendimin përfundimtar të organit kompetent në ndërmarrje ose nëse ai organ nuk merr vendim në afatin prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës ose të kundërshtimit, ka të drejtë në aftin e ardhshëm prej 15 ditëve të kërkojë mbrojtje të drejtave para gjykatës kompetente. Në rastin konkret Shkalla e I-rë ka konstatuar se padia e ushtruar s’pari para Gjykatës Komunale në Viti, si C.nr 5/2007 e që kjo Gjykatë me aktvendimin të datës 26 tetor 2011, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, e pastaj padia tjetër para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme që ka marrë shenjen C-II-0052-C0001, për çështje me objekt të njëjtë dhe palë të njëjta sipas propozimit të ushtruar në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar, në Prishtinë e i cili ishte dorëzuar me post brenda afatit ligjor, kjo padi është e pa pranueshme dhe e pa

lejuar, për faktin se s'pari me padinë e parë është krijuar gjygjëvarisa, në raport me padinë e dytë, e cila është dorëzuar pas aftit ligjor që është paraparë me nenin 83, paragrafi 1, të Ligjit themelorë për marrëdhëniet e punës i RSFJ-së.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësi ka dështuar të sjellë prova, se si është vendosur kërkesa sipas propozimit që është ushtruar në Gjykatën themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, ndërsa ai pa siguruar asnjë provë të vetme për atë procedurë, ka ushtruar padinë e dytë, e që në fakt kjo padi është e pas afatshme.

Shkalla e I-rë ka konstatuar se sikur paditësi të kishte siguruar numrin e lendes në Gjykatën themelore të Punës së Bashkuar, në Prishtinë ose nëse siç ka pretenduar, lënda është zhdukur, ai ka pasur mundësi të beje ripërtërije të shkresave të lendes sipas rregullores së punës për organizimin e gjykatave dhe nuk ka pasur nevojë të ushtroje padinë e vitit 2007, për të cilën padi është lëshuar afatit ligjor.

Po ashtu Shkalla e I-rë ka arsyetuar se me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë është munduar të shtjerrë të gjitha mjetet që paditësit të jep mundësinë të evitojë të gjitha pengesat procedurale për të kaluar në shqyrtimin merititor të kërkesës por paditësi nuk ka vepruar, kështu që padia e ushtruar në vitin 2007 është e pas afatshme dhe si e tille është e pa pranueshme.

Me 14 nëntor 2022, paditësi për mes postës e ka dërguar një ankesë në DHPGJS të paraqitur kundër Aktvendimit të shkallës së I-rë të DHPGS, C-II-13-0052-C0001, për shkak të gjitha arsyeve ankimore. Në këtë ankesë paditësi/ankuesi i ka propozuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës që pas mbajtjes së seancës së kolegjit të merr vendim me të cilin do ta aprovojë këtë ankesë, ndërsa aktvendimi i atakuar me këtë ankesë të ndryshohet dhe këtë çështje ta gjykojë duke e aprovuar në tersi kërkesëpadinë e paditësit B S ose të priset aktvendimi i goditur dhe lëndën ta kthejë në shkallë të I-rë në DHPGJS-së në procedim të serishëm. Paditësi/ankuesi në ankesën e parashtruar ka theksuar se Organi i Dhunshëm Serb i instaluar në ndërmarrje i ka ndërprere marrëdhënien e punës atij pa udhëhequr kurrfarë procedure Ligjore dhe ka marrë aktvendim për ndërprerje të Marrëdhënies së punës me nr. Vendimi 345 i datës 19 qershor 1991. Kundër këtij aktvendimi paditësi me kohe ka ushtruar kundërshtim më date 21 qershor 1991. Më 25 qershor 1991 e paditura e ka refuzuar kundërshtimin e paditësit me nr. vendimi 369. Pas refuzimit të kundërshtimit paditësi ka filluar procedure në Gjykatës e punës së Bashkuar në Prishtinë për anulimin e këtij vendimi. Me qenë kjo

çështje nuk ishte zgjidhur dhe përfunduar asnjëherë, ju ka drejtuar Gjykatave të Rregullta pas Luftës me të cilin këto Gjykata janë shpallur In kompetente dhe lënda ju ka dërguar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës ku më 06 gusht 2014 është mbajtur seance ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesi e palës së paditur, dhe se me vet faktin është mbajtur seance për këtë çështje dhe asnjë prove e prezantuar në këtë seance nuk është kundërshtuar nga e paditura. Padiësi/ankuesi pretendon se në këtë fazë të procedurës, Gjykata nuk mund ta hedhë padinë si të pa pranueshme pas mbajtjes së disa shqyrtimeve dhe se ajo ka qenë dashur të vendose për çështjen kryesore me aktgjykim.

Padiësi pohon se ka vepruar sipas Udhëzimeve të Gjykatës dhe kemi dërguar kërkesa- Formularin për shumën e kompozimit në shumë prej 31,000.00 euro për periudhën e largimit nga puna nga data 26 qershor 1991 deri me datën 21 qershor 1999 e gjithë kjo me kamat Ligjore sipas Ligjit të AKP-së. Ka shtuar se me vetë faktin se me parashtrësë kemi kërkuar vazhdimin e kësaj çështje ashtu siç parashihet edhe në aktvendimin e kësaj Gjykate dhe se Gjykata ka vepruar drejt kur ka lejuar hapjen e kësaj lende dhe ka ndërmarrë veprimet e duhura deri më tani.

Padiësi/ankuesi ka konsiderua se Shkalla e I-rë e DHPGJSK-së fare nuk e ka marrë në konsideratë provat e ofruara nga ai. Tutje ka pohuar se Shkalla e I-rë ka vepruar drejtë duke hapur çështjen edhe pse e paditura e ka kundërshtuar një gjë të tillë dhe se padiësi ka paraqitur Kundërshtimet, ankesat dhe kërkesa tani i mbetet Autoritetit të Gjykatës që të vendos në mënyre objektive dhe të drejtë duke marr parasysh edhe kohën e kaluar 30 vite që nga largimi nga puna e deri më sot, kjo që do të ishte një kompozim modest.

Po ashtu padiësi/ankuesi ka theksuar se Shkalla e I-rë ka bërë vërtetim të gabuar kur gjykata gabimisht ka vërtetuar faktin se pa marrë në konsideratë se padiësi me kohë dhe afate ka parashtruar propozimin në Gjykate, në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar dhe nuk është faji i tij se lëndët e tilla janë asgjësuar dhe për këtë kem edhe dëshmitë ku Gjykata Komunale zyrtarisht ka kërkuar nga Arkivi i Kosovës, por nuk ka marruar përgjigje dhe se tani ajo ka lëshuar një vërtetim me të cilin dëshmon se lëndët e kësaj Gjykate nuk janë regjistruar në Gjykatën komunale në Viti.

Po ashtu paditësi / ankuesi në ankesën e parashtruar nëpërmjet përfaqësuesit ka theksuar se Shkalla e I-rë ka bere shkelje esenciale te dispozitave të Procedurës Kontestimorë ne nga neni 182 par 1 në lidhje me nenin 8 dhe nenin 160.4 të LPK-së sepse përpos se të theksuarve me larte shkalla e I-rë nuk ka paraqitur se cilat fakte i ka shfrytëzuar dhe i ka vlerësuar ato. Është e drejtë e Gjykatës që të vendos sipas bindjes se lire, por gjithsesi kjo bindje duhet të derivoj nga provat për të mos qenë arbitrare. Po ashtu paditësi / ankuesi në ankesën po ashtu ka theksuar se Shkalla e I-rë gabimisht ka bere zbatim të nenit 392 par.1 pika f të Ligjit LPK ku pas disa seancave dhe pothuajse se më tepër se 30 vite tani gjeti se padia është e pa afatshme, ky argument nuk qëndron dhe si ti tillë besojmë se Kolegji i Apelit do ta shqyrtojë dhe analizoje mire këtë çështje juridike Civile, sepse në rastet e ngjashme ka prishur aktvendimet e tilla.

Me 19 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS përgjigjen ndaj kësaj ankese. Në këtë parashtrësë AKP-ja ka pohuar se argumentet e veta qartësisht i ka sqaruar në mbrojtjen në ankesë, andaj përsëritja e tyre do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktvendimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në vitin 2007, e ka dorëzuar padinë, kundër të paditurës NSH" Agromorava", për anulimin e vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës- vendimit 369, të datës 26 qershor 1991 dhe kompensimin e të ardhurave personale, në Gjykatën Komunale në Viti, me shenjen C.nr.5/2007, por që kjo Gjykate me aktvendimin e saj C.nr.7/2007 të datës 26 tetor 2011, ishte shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, dhe paditësi është udhëzuar ti drejtohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme

Shkalla e I-rë kishte marrë Aktvendim me të cilin padia e paditësit B S kundër të paditurës, në lidhje me anulimin e vendimeve të paditurës për ndërprerje të marrëdhënies së punës, gjegjësisht Vendimit nr.369, datë 26 qershor 1991, dhe kompensim të ardhurave, hedhet poshtë si e pa pranueshme.

Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë, e cila ka konstatuar se paditësi sipas parimit të barrës së provës, në kuptim të nenit 31.5, të Ligjit nr.06/L086, nuk e ka vërtetuar faktin se propozimi kundër të paditurës a është regjistruar në regjistrin e lëndëve në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, pastaj kjo lëndë është marrë në punë dhe nëse për këtë rast është vendosur, me ndonjë vendim meritor.

Kolegji i Apelit po ashtu e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë e cila ka konstatuar se paditësi ka dështuar të sjellë prova, se si është vendosur kërkesa sipas propozimit që është ushtruar në Gjykatën themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë, ndërsa ai pa siguruar asnjë provë të vetme për atë procedurë, ka ushtruar padinë e dytë, e që në fakt kjo padi është e pas afatshme. Edhe Kolegji i Apelit ashtu siç ka konstatuara Shkalla e I-rë, vlerëson se nëse lënda është zhdukur ashtu siç pretendon paditësi, ai ka pasur mundësi të bëjë ripërtërije të shkresave të lëndës, por ai këtë nuk e ka bërë, andaj padia e re e ushtruar në vitin 2007, për të njëjtën çështje është e papranueshme, prandaj me të drejtë me rastin e vendosjes është aplikuar nenin 391, paragrafi 1, pika f të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Kolegji i Apelit gjithashtu vlerëson se paditësi në një far mënyrë ka qen joaktiv lidhur me çështjen e tij juridike për të ndjekur procedurat gjyqësore në Gjykatë, pasi që nga viti 2001 e tutje ai ka mundur të paraqitet në Gjykata, por ai kishte zgjedhur të mos e bëjë këtë deri në vitin 2007, kur e ka paraqitur padinë e tij.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë i ka dhen mundësi paditësit të evitojë pengesat procedurale për të kaluar në shqyrtimin meritor të kërkesës dhe ka lëshuar disa urdhra në mënyrë që paditësi të ofroj dëshmi por pa sukses nga ana e paditësit.

Kolegji i Apelit i ka shqyrtuar dhe vlerësuar pretendimet ankimore të paditësit, mirëpo nuk ka gjetura se ka shkelje, prandaj nuk mund të pajtohet me pretendimet e paditësit, pasi që të njëjtat nuk janë të argumentuara dhe nuk janë të mbështetura në Ligj.

Kolegji i Apelit ka vlerësuar pretendimet e paditësit lidhur me atë se aktvendimi i ankimuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuara dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe ka gjetur se perëndimet e paditësit janë të pathemelta ngase Shkalla e I-rë ka vlerësuar provat e ofruara nga palët ndërgjyqëse, madje edhe ka mbajtur seancë dëgjimore duke ju dhënë mundësi palëve të paraqesin qëndrimet e veta edhe me gojë dhe pastaj ka marr aktvendim i cili sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit është i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Po ashtu pretendimet e paditësit se Aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182.2 pika n) sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit, nuk janë të themelta, kjo për shkak se Shkalla I-rë e ka garantuar objektivitet dhe ligjshmërinë e procesit gjyqësor duke kërkuara nga palët me shkrim përmes urdhrave sigurimin e provave në mënyrë që të konsistojë faktet thelbësore e për të cilat gjykata ka dhen arsyetimin e duhur.

Kolegji i Apelit po ashtu vlerëson se Shkalla e I-rë, ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme të drejtën materiale, andaj vlerëson po ashtu si të pathemelta pretendimet e paditësit se nuk janë aplikuara në mënyrë të drejtë dispozita ligjore.

Prandaj duke u bazuar në këto arsye, është i sakte rezultati i dhënë me aktvendimin e ankimuar nga ana e Shkallës se I-rë dhe ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet Aktvendimi i ankimuar i Shkallës se I-rë si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore:

Paditësi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, në shumë prej 30 euro, me datë 15 dhjetor 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit, me datë 18 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtari kryesues _____